



Planuar / Dorezuar Primiçen/Prodato Received/Delivery	20.05	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINSHICK	2956/2022		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.273/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.273/2022 të datës 23.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë fshati kundër Vendimit me 07/4Nr. Prot:935 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 20.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.273/2022 të datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër 07/4 protokollit 934 të datës 28.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, në pozitë “Inspektore teknike -Gjilan”, sipas Akt Emërimit të datës 03.01.2013, i është ndërprerë pagesa e 50% e pagës me Vendimin me numër 07/4 protokollit 934 të datës 28.02.2022 nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, duke plotësuar dhe ndryshuar Vendimin Ref.07/04/88/2021 të protokollit:4444 të datës 25.06.2021 të Komisionit Disiplinor, me rastin e pezullimit të pesë (5) nëpunësve civil, ku ka qenes i përfshirë dhe ankuesja.

Kundër Vendimit me numër 07/4 protokollit 934 të datës 28.02.2022, ankuesja me datë 23.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 23.03.2022 me numër të ankesës A.nr.273/2022 dhe Nr. Prot:1526/2022, të pranuar nga ana e saj me datë 10.03.2022, sipas dërgesës postare të nënshkruar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datë 31.03.2022 ankesën e

ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, më datë 06.04.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 1526/2022 e datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:5538 të datës 30.08.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Vendimin me 07/4Nr. Prot:935 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Vendimin me Nr. Prot:4444 të datës 25.06.2021 për pezullimin e nëpunësve civil; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 06.04.2022; Akt Emërimit i datës 03.01.2013 për ankuesen; Informim me nr. protokolli 969 i datës 03.03.2021; Shkresën për shqyrtimin e kërkesës me Nr. Prot:1226 e datës 18.03.2021; E-mail i datës 18.03.2021; Vendim nr.prot.5072 i datës 21.09.2021 nga zv. Drejtori Ekzekutiv AZHB-së; Vendim nr.prot.4015 i datës 21.09.2019 ; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 12.03.2021;Procesverbal i datës 19.03.2021; Shkresën për shqyrtimin e kërkesës me Nr. Prot:1312 e datës 25.03.2021; Vendim nr.prot.1389 i datës 30.03.2021; Shkresën për shqyrtimin e kërkesës KD me Nr. Prot:2545 e datës 26.05.2021; E-mail i datës 26.03.2021; Vendim nr.prot.1420 i datës 30.03.2021; Memorandum zyrtar nga Policia e Kosovës e datës 09.03.2021; Memorandum zyrtar nga Policia e Kosovës e datës 16.03.2021; Memorandum zyrtar nga Policia e Kosovës e datës 01.04.2021; Memorandum zyrtar nga Policia e Kosovës e datës 21.04.2021; Memorandum zyrtar nga Policia e Kosovës e datës 17.05.2021; Njoftim i datës 12.05.2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Memorandum zyrtar nga Policia e Kosovës e datës 20.05.2021; Memorandum zyrtar nga Policia e Kosovës e datës 24.05.2021; Kërkesë e datës 23.03.2021 nr.protokolli 1278; E-mail i datës 23.03.2021; E-mail i datës 18.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 12.03.2021; Shkresën për shqyrtimin e kërkesës Nr. Prot: 1196 e datës 18.03.2021; E-mail i datës 17.03.2021; Vendim nr. 5072 i datës 21.09.2020; E-mail i datës 25.02.2021;Vendimin me Nr. Prot:5480 i datës 20.08.2021 për ndryshim dhe plotësim te vendimit ref. AZHB 07/4/44/2021 i datës 30.03.2021 per KD; Dërgesë e datës 10.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar pretendimet e ankueses dhe provat e lëndës veç e veç, ka konstatuar se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 03.01.2013 është e punësuar në pozitë "Inspektore teknike Gjilan", në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë.

Me datë 03.03.2021 Policia e Kosovës në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda përmes shkresës informuese me numër protokolli 969/2021 e ka informuar Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me ankuesen e cila është në arrestim që nga data 24.02.2021 nga Hetuesi i Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë, lidhur me caktimin e masës së paraburgimit, me dyshimin se e njëjta ka kryer vepër penale "marrje ryshfeti" ne bashkëkryerje sipas nenit 421 te KPRK-se dhe "keqpërdorim të pozitës apo autoritetin zyrtar", nga neni 414 të KPRK-se. Zëvendësuesi Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë -AZHR-së, për këtë çështje është njoftuar me datë 10.03.2021 përmes E-mailit të Arkivit të Ministrisë. Menaxherja e Personelit të AZHB-së me datë 11.03.2021 ka parashtruar kërkesë tek Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinës/Departamenti për Krime të Rënda, lidhur me rastin e arrestimit të ankueses, për shkak të procedimit të çështjes në procedurë të mëtejme, e cila me datë 12.03.2021 ka pranuar njoftimin lidhur me shqiptimin e masës së paraburgimit ndaj zyrtareve të AZHB-së, duke përfshirë dhe ankuesen.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se me datë 18.03.2021 Menaxherja e Personelit të AZHB-se, ka përcjell pranë Komisionit Disiplinor të AZHB-së, kërkesën e datës 18.03.2021 të Udhëheqësit të drejtpërdrejt të ankueses për inicim të procedurës disiplinore ndaj saj. Kryeshafi Ekzekutiv i AZHB-së nxjerr vendimin REF.AZHB-07/4/45/2021 të datës 30.03.2021 me numër të protokollit 1420 me të cilin vendim pezullohet nga puna ankuesja nga data 30.03.2021 deri na marrjen e vendimit të Komisionit Disiplinor si dhe zyrtari nga pika 1 e vendimit do të marrë 50% të pagës së tij gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit deri në marrjen e vendimit tjetër.

Më datë 26.05.2021 Menaxherja e Personelit e AZHB-së ka përcjell pranë Komisionit Disiplinor të AZHB-së kërkesën e datës 26.05.2021 të Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses për dyshim të shkeljeve ligjore “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, andaj Komisioni Disiplinor ka nxjerr Vendimin me numër 07/4 me Prot.4444 të datës 25.06.2021 me të cilin vendim është pezulluar nga puna ankuesja Pas opinionit ligjor të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të datës 24.02.2022, Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër protokollit 934 të datës 28.02.2022, ka ndryshuar pikën tre (3) të Vendimit me numër të protokollit 4444 të datës 25.06.2021, ashtu që ankueses i është ndërprerë pagesa e 50% e pagës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Ligji për Zyrtarët Publikë nuk jep ndonjë sqarim të detajuar lidhur me masën e pezullimit sepse nuk përcaktohet që vetëm për gjashtë muaj duhet t'i bëhet kompensimi i 50% të pagës, duke pretenduar se është ende në procedurë gjyqësore duke theksuar se përderisa nuk ka vendim përfundimtar nuk mund të më ndalohet kompensimi i 50% të pagës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e nenit 56 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me pezullimin sipas detyrës zyrtare, me të cilat është përcaktuar se: *Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji; ... ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 5 i po këtij ligji parasheh se: Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”, andaj bazuar në këto dispozita ligjore Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor mund të zbatoj masën e pezullimit të nëpunësit civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore, në rast se vlerëson se qëndrimi apo ushtrimi i detyrës nga nëpunësi civil do të pengonte hetimin disiplinor apo do të përbënte cenin të detyrave të tij të punës.*

Po ashtu, Kolegji duke u bazuar në dispozitat e nenit 58 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore dhe në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 56, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në 6 muaj, konstatoi se në rast të pezullimit të nëpunësit civil sipas nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të këtij Ligji, kompensimi prej 50% e pagës do të bëhet vetëm për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj të pezullimit, rrjedhimisht çdo pezullim i vazhduar pas kësaj periudhe, nuk bart të drejtën e kompensimit prej 50% të pagës së nëpunëses civile të pezulluar, andaj mbi këtë bazë ligjore përcaktohet se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë verën se i njëjti ju referohet pesë (5) nëpunësve civil, ku që të gjithë janë pezulluar nga Komisioni Disiplinor deri në një vendim tjetër, kështu që refuzimi i ankesës A.nr.273/2022 të datës 23.03.2022 dhe lënia në fuqi e Vendimit me numër protokollit

934 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, ka të bëjë vetëm me pjesën e ankueses.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.273/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencisë e Zhvillimit të Bujqësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

